

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
KOMITETI PËR AUDITIM



Raporti për punën e Komitetit për auditim për vitin 2021 (përmbledhje)

maj, 2022

Hyrje

Gjatë vitit 2021, Komiteti i Auditimit (Komiteti) ka vazhduar me aktivitetet e tij të rregullta në bazë të akteve dhe praktikave që e rregullojnë punën e tij. Komiteti ka kryer aktivitetet e tij mbikëqyrëse duke mbajtur seanca, në të cilat ka mbikëqyrur punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, Drejtorisë së Operacioneve Financiare dhe Kontabilitetit, si dhe auditimit të jashtëm.

Në këto seanca, Komiteti u informua rregullisht për fushat që mbikëqyr, në fushën e politikave kontabël dhe raportimit financiar, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrollet e brendshme dhe përputhshmërinë e operacioneve aktet ligjore dhe nënligjore. Për njohje më të detajuar në disa çështje, anëtarët e Komitetit kërkuar informacione shtesë dhe takime.

Anëtarët e Komitetit të Auditimit

Me Vendimin për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit O nr. 02-15/XIX-2/2021, nga 3 dhjetor 2021, u themelua Komiteti i Auditimit i përbërë nga tre anëtarë joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore, me çka u ndërpre bashkpunimi me bashkëpunatorin e jashtëm.

Gjatë vitit 2021, seancat e Komitetit i udhëhiqte kryetari i Komitetit.

Seancat e Komitetit të Auditimit

Komiteti i Auditimit ka mbajtur pesë seanca në vitin 2021 ku janë shqyrtuar çështjet që hyjnë në fushën e Komitetit të Auditimit, sipas akteve të Bankës Popullore, Rregullores së Punës dhe Udhëzimit për punën e Komitetit të revizionit. Në seanca, sipas nevojës, me ftesë të Komitetit kanë marrë pjesë: këshilltari i guvernatorit, shefi i auditimit të brendshëm të Drejtorisë për auditim të brendshëm, drejtori i Drejtorisë së Operacioneve Financiare dhe Kontabilitet, drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe përfaqësuesit e auditorit të jashtëm.

Është e rëndësishme të theksohet se me Vendimin i ri për themelimin e Komitetit të Auditimit dhe përcaktimin e fushës së punës së tij, sigurohet njohje e qartë e objektivave, si dhe të kompetencave dhe përgjegjësi të Komitetit që i janë caktuar nga Këshilli i Bankës Popullore. Në të njëjtën kohë, po përmirësohet korniza për kryerjen e aktiviteteve të Komitetit për vlerësimin e efektivitetit dhe përshtatshmërisë së përgjithshme të procesit të raportimit financiar, proceseve të auditimit, sistemit të kontroleve të brendshme dhe përputhshmërisë së operacioneve, me qëllim forcimin e funksionit të kontrollit të menaxhimit të korporatës.

Drejtoria për auditim të brendshëm

Komiteti ka mbikëqyrur punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ka shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm, gjetjet dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Rregullisht janë shqyrtuar dhe miratuar Raporti për funksionimin e auditimit të brendshëm në vitin 2020 dhe në gjysmën e parë të vitit 2021. Gjithashtu është miratuar Programi i punës së

Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, Programi afatmesëm i punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2022 – 2024 dhe Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Njëkohësisht, anëtarët e Komitetit të Auditimit dhanë udhëzime që i referoheshin informacioneve të caktuara për përcjellje të rekomandimeve, të përshkruara në raportet e dorëzuara të auditimit të brendshëm. Përkatësisht, Komiteti vlerësoi se këto informacione janë të rëndësishme për analizën e gjendjes aktuale, nga Këshilli i Bankës Popullore.

Drejtorisë për operacione financiare dhe kontabilitet

Komiteti ka mbikëqyrur punën e Bankës Popullore, ndër të tjera, përmes raporteve financiare dhe llogarisë vjetore të përgatitur nga Drejtoria për operacione financiare dhe kontabilitet. Janë shqyrtuar Raportet financiare të Bankës, llogaria vjetore, Vendimi për miratimin e Llogarisë vjetore dhe Raporteve financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 dhe për shpërndarjen të rezultatit financiar për shpërndarje për vitin 2020.

Auditimit të jashtëm

Një aktivitet i veçantë në punën e Komitetit ishte mbikëqyrja i punës së auditimit të jashtëm. Komiteti ka mbajtur seanca me auditorët nga Shoqëria e auditimit "DILOIT" Sh.P.K Shkup. Kështu, auditori i jashtëm e informoi Komitetin për auditimin e kryer të raporteve financiare për vitin 2020 dhe të tyre pajtueshmërinë së tyre me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar.

Në Raportin e auditorit të pavarur për auditimin e kryer të raporteve financiare të Bankës Popullore për vitin 2020 është dhënë mendim pa kualifikim, përkatësisht mendim se raportet financiare të parashtuara, në mënyrë objektive paraqesin gjendjen financiare të Bankës Popullore më 31.12.2020 në të gjitha nga aspektet materiale, si dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve monetare për atë vit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Kryetari i Komitetit të Auditimit
të Bankës Popullore